



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE TË BQK-së  
/për & deri tremujorin e parë 2024/  
**-Raport i ndërmjetëm i paaudituar-**

Departamenti për Planifikim dhe Raportim Financiar

## Pasqyrat financiare të BQK-së për tremujorin e parë 2024

E përcaktuar me Ligjin 03/L-209 “Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (me iniciale BQK), si kornizë raportuese për përgatitjen e pasqyrave financiare janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, përkatësisht nenit 58 të Ligjit të lartpërmendur. Këto pasqyra për tremujorin e parë përfshijnë pasqyrën e gjendjes financiare dhe llogarinë e përmbledhur të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe rezerva (ekuitet). Viti financiar i BQK-së përputhet me vitin kalendarik, si rrjedhojë, data e raportit për pasqyrat financiare të tremujorit të parë 2024 është 31 Mars 2024.

### **Shkurtesa të përdorura në raport:**

- BQK – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
- FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar
- DST (SDR) – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes
- SNP – Sistemi Ndërbankar i Pagesave
- BQE (ECB) – Banka Qendrore Evropiane
- EUR – Valuta euro
- USD – Dollari Amerikan
- RFI (IFSH) – Instrumenti i Financimit të Shpejtë
- SBA - Marrëveshje aktive për shfrytëzim të linjës kreditore

## Pasqyra e gjendjes financiare

sipas të dhënave me:

	Shënim	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
<b>Mjetet</b>			
Paraja e gatshme	5	114,278,378.30	101,931,866.18
Llogaritë rrjedhëse	6	325,686,836.41	426,076,735.56
Letrat me vlerë	7	629,949,586.36	717,814,023.91
Plasmanët në tregun e parasë	8	282,164,743.98	205,252,453.47
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	178,424,347.24	178,261,036.26
Prona dhe pajisjet	10	4,207,752.55	4,275,739.08
Mjetet e paprekshme	11	847,960.26	896,319.28
Mjete tjera	12	2,162,946.84	2,475,581.90
<b>Gjithsej mjetet</b>		<b>1,537,722,551.94</b>	<b>1,636,983,755.64</b>
<b>Detyrimet</b>			
Ndaj bankave komerciale në vend	13	528,724,136.33	590,622,072.61
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	185,407,832.70	184,216,991.06
Ndaj institucioneve qeveritare	15	613,243,585.48	511,903,456.25
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	98,835,070.45	240,201,714.61
Nga huamarrja/et	17	1,558,590.95	1,661,655.62
Detyrime tjera vendore	18	2,346,855.11	9,221,562.98
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>1,430,116,071.02</b>	<b>1,537,827,453.13</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali i autorizuar	19	30,000,000.00	30,000,000.00
Fondet rezervë	20	69,156,302.51	41,525,187.85
Neto rezultati i periudhës		8,450,178.41	27,631,114.66
<b>Gjithsej kapitali dhe rezervat</b>		<b>107,606,480.92</b>	<b>99,156,302.51</b>
<b>Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat</b>		<b>1,537,722,551.94</b>	<b>1,636,983,755.64</b>

Shpalosjet përkatëse sipas shënimeve prej faqes 6 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare dhe shpalosjet përkatëse të tyre janë aprovuar nga organet vendimmarrëse<sup>1</sup> më datë 26 Qershor 2024 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:

[Ahmet Ismaili]

Nënshkruar nga:  
Ahmet Ismaili  
Guvernator

[Faton Ahmetaj]

Nënshkruar nga:  
Faton Ahmetaj  
Drejtor  
Departamenti i Financave

<sup>1</sup> Sipas nenit 34 dhe 59 të Ligjit nr. 03/L –209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

## Pasqyra e përmbledhur e të ardhurave

	Shënim	31 Mars 2024	31 Mars 2023
<b>Të hyrat nga interesi (kamata)</b>			
Të hyrat nga interesi		10,315,868.81	5,330,591.32
Shpenzimet nga interesi		(2,931,456.83)	(1,849,223.82)
<b>Neto të hyrat nga interesi</b>	21	<b>7,384,411.98</b>	<b>3,481,367.50</b>
<b>Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat</b>			
Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat		1,067,110.13	877,241.44
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		(328,510.40)	(332,032.24)
<b>Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat</b>	22	<b>738,599.73</b>	<b>545,209.20</b>
<b>Të hyrat nga aktiviteti rregullator dhe të hyra tjera operative</b>			
Të hyrat nga aktiviteti rregullator	23	1,838,500.00	1,608,953.68
Të hyrat nga grantet	24	8,773.64	9,108.00
Të hyrat tjera operative	25	1,798.26	1,783.22
<b>Të ardhurat operative (21+22+23+24+25)</b>		<b>9,972,083.61</b>	<b>5,646,421.60</b>
<b>Shpenzimet administrative</b>			
Shpenzimet për personelin	26	(1,253,667.17)	(1,257,137.40)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	(212,911.64)	(204,577.09)
Shpenzime të përgjithshme administrative	27	(247,778.18)	(289,211.31)
<b>Shpenzimet administrative</b>		<b>(1,714,356.99)</b>	<b>(1,750,925.80)</b>
<b>Neto rezultati pa efektin e kursit të këmbimit dhe të provizioneve për humbjet e pritura kreditore</b>		<b>8,257,726.62</b>	<b>3,895,495.80</b>
Neto fitimi/(humbja) nga kursi i këmbimit valutor	28	181,792.43	(122,774.84)
Provizioni për humbjet e pritura kreditore [neto rritja/(zvogëlimi)]	4	10,659.36	(56,126.03)
<b>Neto rezultati i periudhës</b>		<b>8,450,178.41</b>	<b>3,716,594.93</b>

Shënimet prej faqes 6 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

## Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet (kapital dhe rezerva)

	Kapitali	Fondi rezervë	Rezervat e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura/ të ardhurat e ndashme	Neto Rezultati	Gjithsej
<b>Gjendja më 1 Janar 2023</b>	<b>30,000,000.00</b>	<b>32,972,924.93</b>	<b>1,529,287.16</b>	<b>8,552,262.92</b>	-	<b>71,525,187.85</b>
Transferimi në fondin rezervë	-	8,063,117.82	489,145.10	(8,552,262.92)	-	-
<b>Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj</b>	-	<b>8,063,117.82</b>	<b>489,145.10</b>	<b>(8,552,262.92)</b>	-	-
Fitimi për vitin Rregullime gjatë vitit	-	-	-	-	27,631,114.66	<b>27,631,114.66</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	-	<b>27,631,114.66</b>	<b>27,631,114.66</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2023</b>	<b>30,000,000.00</b>	<b>39,506,755.59</b>	<b>2,018,432.26</b>	-	<b>27,631,114.66</b>	<b>99,156,302.51</b>
<b>Gjendja më 1 Janar 2024</b>	<b>30,000,000.00</b>	<b>39,506,755.59</b>	<b>2,018,432.26</b>	<b>27,631,114.66</b>	-	<b>99,156,302.51</b>
Transferimi në fondin rezervë	-	-	-	-	-	-
<b>Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj</b>	-	-	-	-	-	-
Fitimi për vitin Rregullime gjatë vitit	-	-	-	-	8,450,178.41	<b>8,450,178.41</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	-	<b>8,450,178.41</b>	<b>8,450,178.41</b>
<b>Gjendja më 31 Mars 2024</b>	<b>30,000,000.00</b>	<b>39,506,755.59</b>	<b>2,018,432.26</b>	<b>27,631,114.66</b>	<b>8,450,178.41</b>	<b>107,606,480.92</b>

Shënimet prej faqes 6 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# Pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

## 1. Institucioni Raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK, e cila operon sipas Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës të aprovuar në korrik të vitit 2010, si dhe plotësim/ndryshimin më 10 mars 2017 në Ligjin nr. 05/L-150.

## 2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

### **Korniza Raportuese**

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### **Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të kostos historike dhe të harmonizuara sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### **Valuta e funksionale dhe e prezantuar**

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në EURO, që është valutë zyrtare funksionale e Kosovës. Në rast se vlerat janë të shprehura në valuta tjera atëherë do të ketë shënim përkatës aty ku janë të paraqitura ato.

## 3. Politikat kontabël

Pasqyrat financiare janë të përgatitura duke shfrytëzuar konsistencën e politikave kontabël dhe duhet theksuar se nuk ka pasur ndonjë politikë të re ose ndryshim në politikat e aplikuara kontabël.

## 4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Rreziku financiar në BQK është i paraqitur në formën e: rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional, rrezikut kreditor dhe rrezikut të tregut. Pesha më e madhe e rrezikut financiar në BQK, ndërlihet kryesisht me punët e menaxhimit të mjeteve dhe aktivitetet operative dhe të cilësisë së rregullatorit dhe menaxhohet nga njësitë organizative përkatëse dhe departamenti i menaxhimit të rrezikut, në përputhje me aktet juridike të aprovuara nga organet vendimmarrëse si Bordi i BQK-së dhe Bordi Ekzekutiv.

Bazuar në kërkesat e standardeve për raportim financiar, sidomos ato që mbulojnë rrezikun kreditor po shpallim elementet se si janë të menaxhuara ekspozimet kreditore dhe të likuiditetit. Portfolio e ekspozimeve është në shtete të Bashkimit Evropian dhe Shtete të Bashkuara të Amerikës me vlerësim kreditor të investueshëm (prej “AAA deri BBB-“ dhe/ose “Aaa deri Baa3”) ekspozimi i listuar në tabelën – vlerësimi (Rangimi) kreditor (faqe 7).

**Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

Vlerat bartëse të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor të ndara sipas llojit dhe të shprehura edhe nga pjesëmarrja në përqindje me gjithsej ekspozimin, janë si më poshtë:

**31 Mars 2024**

Vlerësimi kreditor (S&P/Moody's/Fitch)	Llogaritë nostro	Plasmanët në tregun e parësë	Letrat me vlerë	Gjithsej vlera bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa/AAA	274,080,967	225,944,843	143,521,028	643,546,839	52.01%
AA+/Aa1/AA+	-	-	90,194,266	90,194,266	7.29%
AA/Aa2/AA	134,141	10,015,167	-	10,149,307	0.82%
AA-/Aa3/AA-	-	-	150,187,509	150,187,509	12.14%
A+/A1/A+	24,664,251	-	-	24,664,251	1.99%
A/A2/A	25,886,598	30,074,467	15,660,346	71,621,411	5.79%
A-/A3/A-	-	16,173,532	193,370,412	209,543,944	16.94%
BBB-/Baa3/BBB-	-	-	37,387,186	37,387,186	3.02%
<b>Gjithsej</b>	<b>324,765,957</b>	<b>282,208,007</b>	<b>630,320,748</b>	<b>1,237,294,715</b>	<b>100.00%</b>

**31 Dhjetor 2023**

Vlerësimi kreditor (S&P/Moody's/Fitch)	Llogaritë nostro	Plasmanët në tregun e parësë	Letrat me vlerë	Gjithsej vlera bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa/AAA	387,108,060	180,215,434	143,866,965	711,190,459	52.75%
AA+/Aa1/AA+	-	-	129,488,930	129,488,930	9.60%
AA/Aa2/AA	-	-	190,575,328	190,575,328	14.13%
AA-/Aa3/AA-	-	-	-	-	0.00%
A+/A1/A+	6,022,678	-	-	6,022,678	0.45%
A/A2/A	21,178,436	-	15,657,821	36,836,257	2.73%
A-/A3/A-	10,533,571	25,063,000	200,755,230	236,351,801	17.53%
BBB-/Baa3/BBB-	-	-	37,836,241	37,836,241	2.81%
<b>Gjithsej</b>	<b>424,842,745</b>	<b>205,278,434</b>	<b>718,180,516</b>	<b>1,348,301,694</b>	<b>100.00%</b>

**Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat e ekspozimit në nivel të fazave sipas kërkesave të SNRF 9. Në datën e raportimit nuk kemi ndonjë ndryshim material në rrezik kreditor që nga njohja fillestare e prandaj të gjitha pasuritë financiare janë në fazën 1.

	31 Mars 2024			31 Dhjetor 2023		
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Faza 1	Faza 2	Faza 3
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	324,765,957	-	-	426,194,235	-	-
Letrat me vlerë (Bono thesari dhe obligacione qeveritare)	630,320,748	-	-	718,180,516	-	-
Plasmanët në tregun e parasë	282,208,007	-	-	205,278,431	-	-
<b>Vlera bartëse</b>	<b>1,237,294,713</b>	-	-	<b>1,349,653,182</b>	-	-
Humbjet e pritura kreditore (HPK)	(501,592)	-	-	(512,251)	-	-
<b>Neto vlera bartëse</b>	<b>1,236,793,121</b>	-	-	<b>1,349,140,931</b>	-	-

Lëvizjet e HPK përkatëse për pasuritë financiare që BQK ka ekspozim gjatë periudhës raportuese janë si më poshtë:

	2024			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
<b>HPK me 1 Janar 2024</b>	<b>512,251</b>	-	-	<b>512,251</b>
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK rritja/(zvogëlimi) për vitin	(10,659)	-	-	(10,659)
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç' regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valutor	-	-	-	-
<b>Saldo më 31 Mars 2024:</b>	<b>501,592</b>	-	-	<b>501,592</b>



**Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

Lëvizjet e HPK përkatëse për pasuritë financiare që BQK kishte ekspozim gjatë vitit 2023 janë si më poshtë:

	2023			Gjithsej
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	
<b>HPK me 1 Janar 2023</b>	<b>459,008</b>	-	-	<b>459,008</b>
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK rritja / (zvogëlimi) për vitin	53,243	-	-	53,243
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç'regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valutor	-	-	-	-
<b>Saldo me 31 Dhjetor 2023:</b>	<b>512,251</b>	-	-	<b>512,251</b>

**Menaxhimi i Rrezikut të Likuiditetit (vazhdim)**

## Vlerat bartëse sipas maturitetit të mbetur

	Shënim	Neto vlera e bartur	më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj - 1 vit	1 - 5 vite	mbi 5 vite
<b>31 Mars 2024</b>							
<b>Mjetet</b>							
Paratë e gatshme	5	114,278,378.30	114,278,378.30	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse	6	325,686,836.41	325,686,836.41	-	-	-	-
Letra me vlerë	7	629,949,586.36	50,091,993.61	53,915,983.38	219,704,294.53	306,237,314.85	-
Plasmanët në tregun e parasë	8	282,164,743.98	201,927,033.13	80,237,710.84	-	-	-
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	152,683,509.35	152,683,509.35	-	-	-	-
		<b>1,504,763,054.40</b>	<b>844,667,750.80</b>	<b>134,153,694.22</b>	<b>219,704,294.53</b>	<b>306,237,314.85</b>	<b>-</b>
<b>Detyrimet</b>							
Ndaj bankave vendore	13	(528,724,136.33)	(528,724,136.33)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	(184,148,513.95)	(5,596.82)	-	-	-	(184,142,917.13)
Ndaj institucioneve qeveritare	15	(613,243,585.48)	(613,243,585.48)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	(98,835,070.45)	(98,835,070.45)	-	-	-	-
Nga huamarrja / et	17	(1,559,317.41)	-	-	(111,379.85)	(891,038.79)	(556,898.77)
Detyrime tjera vendore	18	(758,048.76)	(758,048.76)	-	-	-	-
		<b>(1,427,268,672.38)</b>	<b>(1,241,566,437.84)</b>	<b>-</b>	<b>(111,379.85)</b>	<b>(891,038.79)</b>	<b>(184,699,815.90)</b>
		<b>77,494,382.02</b>	<b>(396,898,687.04)</b>	<b>134,153,694.22</b>	<b>219,592,914.68</b>	<b>305,346,276.06</b>	<b>(184,699,815.90)</b>
<b>31 Dhjetor 2023</b>							
<b>Mjetet</b>							
Paratë e gatshme	5	101,931,866.18	101,931,866.18	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse	6	426,076,735.56	426,076,735.56	-	-	-	-
Letra me vlerë	7	717,814,023.91	42,170,258.25	74,272,691.21	267,436,551.04	333,934,523.40	-
Plasmanët në tregun e parasë	8	205,252,453.47	130,184,227.72	75,068,225.75	-	-	-
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	152,619,115.39	152,619,115.39	-	-	-	-
		<b>1,603,694,194.51</b>	<b>852,982,203.11</b>	<b>149,340,916.96</b>	<b>267,436,551.04</b>	<b>333,934,523.40</b>	<b>-</b>
<b>Detyrimet</b>							
Ndaj bankave vendore	13	(590,622,072.61)	(590,622,072.61)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	(182,925,420.47)	(5,566.53)	-	-	-	(182,919,853.94)
Ndaj institucioneve qeveritare	15	(511,903,456.25)	(511,903,456.25)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	(240,201,714.61)	(240,201,714.61)	-	-	-	-
Nga huamarrja / et	17	(1,661,655.62)	-	-	(221,554.14)	(886,216.12)	(553,885.36)
Detyrime tjera vendore	18	(757,474.20)	(757,474.20)	-	-	-	-
		<b>(1,528,071,793.76)</b>	<b>(1,343,490,284.20)</b>	<b>-</b>	<b>(221,554.14)</b>	<b>(886,216.12)</b>	<b>(183,473,739.30)</b>
		<b>75,622,400.75</b>	<b>(490,508,081.09)</b>	<b>149,340,916.96</b>	<b>267,214,996.90</b>	<b>333,048,307.28</b>	<b>(183,473,739.30)</b>

## 5. Paraja e gatshme

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
Paraja e gatshme	114,278,378.30	101,931,866.18
<b>Gjithsej</b>	<b>114,278,378.30</b>	<b>101,931,866.18</b>

Vërehet një rritje e saldës së parasë së gatshme më 31 Mars 2024 krahasuar më 31 dhjetor 2023. Kryesisht e rrjedhur nga operacionet ditore me para të gatshme por që vlerësohet të jetë brenda kornizave të aktivitetit.

## 6. Llogaritë rrjedhëse (nostro - me bankat jo rezidente)

Përbërja e llogarive rrjedhëse me banka jo vendore është si më poshtë:

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
Deutsche Bundesbank	213,443,219.70	319,333,264.53
Raiffeisen Zentralbank	24,664,251.27	6,022,678.28
Banque Centrale du Luxembourg	60,372,383.47	67,528,944.86
Deutsche Bank	4,810,188.70	10,533,612.55
Commerzbank AG	553,050.76	1,077,538.03
Bank of Lithuania	20,523,358.85	20,100,898.14
DZ Bank AG	134,140.69	20.00
Federal Reserve Bank (FED-NY)	265,364.11	245,788.91
	<b>324,765,957.55</b>	<b>424,842,745.30</b>
Interesi i aktual	1,008,043.92	1,351,489.43
<b>Gjithsej vlera bartëse</b>	<b>325,774,001.47</b>	<b>426,194,234.73</b>
Humbjet e pritura kreditore (HPK)	(87,165.06)	(117,499.17)
<b>Gjithsej vlera neto</b>	<b>325,686,836.41</b>	<b>426,076,735.56</b>

Zëri i llogarive rrjedhëse (nostro) krahasuar më 31 dhjetor 2023 është zvogëluar, ndryshimi është rrjedhë e aktivitetit të këtyre llogarive dhe e menaxhimit të portofolios së mjeteve e afektuar edhe nga normat e interesit në tregjet financiare (përkatësisht shënimet 5, 6, 7 dhe 8, që janë shumë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën referuar nga aspekti i menaxhimit të mjeteve). Norma e interesit efektiv në llogari rrjedhëse (nostro) në periudhën raportuese të vitit 2024 mesatarisht është 3.923% vjetore (ndërsa, në vitin 2023 periudha e njëjtë, mesatarisht ka qenë në rreth 2.97% vjetore)

## 7. Letrat me Vlerë (Bonot e thesarit dhe obligacionet)

Të dy kategoritë që bëjnë pjesë në kuadër të grupit nën shënimin 7 janë letra të borxhit të lëshuara (emetuara) nga vende dhe institucione të ndryshme të Evropës dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në analitikë në faqe 12 janë listuar sipas shpërndarjes gjeografike (në tabelën sipas shpërndarjes gjeografike).

Bonot e Thesarit të shpalosura po ashtu në faqe 12, kanë maturitet të kontraktuar deri në një vit. Ndërsa, ato të obligacioneve qeveritare kanë maturitet të kontraktuar prej një viti deri në mbi pesë vite. Norma e interesit efektiv në letra me vlerë në periudhën raportuese të vitit 2024 variron në segment nga -0.014% deri 5.034% vjetore (ndërsa, në vitin 2023 variron në segment nga -0.014% deri në 5.034% vjetore).

**7. Letrat me vlerë – vazhdim / sipas shpërndarjes gjeografike dhe llojit:****Letrat me vlerë /sipas shpërndarjes gjeografike (vazhdim):**

<b>Shteti</b>	<b>Vlera e bartur 31 Mars 2024</b>	<b>Humbjet e pritura kreditore</b>	<b>Neto vlera 31 Mars 2024</b>
Gjermani	80,577,863.26	(34,329.64)	80,543,533.62
Francë	49,725,252.17	(20,955.27)	49,704,296.90
Holandë	48,691,417.64	(19,798.58)	48,671,619.06
Finlandë	40,804,098.50	(16,653.92)	40,787,444.58
Slloveni	20,718,976.31	(26,627.66)	20,692,348.65
Luksemburg	9,823,368.39	(1,273.11)	9,822,095.28
Belgjikë	90,250,185.62	(45,405.38)	90,204,780.24
Austri	49,390,167.78	(18,732.60)	49,371,435.18
Irlandë	10,212,071.65	(1,098.61)	10,210,973.04
Amerikë	4,428,378.57	(731.35)	4,427,647.22
Itali	37,387,185.86	(32,860.48)	37,354,325.38
Poloni	15,660,346.32	(33,081.35)	15,627,264.97
Kosovë	172,651,435.88	(119,615.31)	172,531,822.23
<b>Gjithsej</b>	<b>630,320,747.95</b>	<b>(371,163.25)</b>	<b>629,949,586.36</b>

<b>Shteti</b>	<b>Vlera e bartur 31 Dhjetor 2023</b>	<b>Humbjet e pritura kreditore</b>	<b>Neto vlera 31 Dhjetor 2023</b>
Gjermani	80,241,529.79	(32,484.26)	80,209,045.53
Francë	69,396,489.52	(33,196.30)	69,363,293.22
Holandë	49,337,464.95	(15,073.93)	49,322,391.02
Finlandë	60,578,203.75	(18,717.51)	60,559,486.24
Slloveni	20,694,509.47	(15,223.95)	20,679,285.52
Luksemburg	9,795,062.84	(1,582.39)	9,793,480.45
Belgjikë	89,857,330.90	(44,177.45)	89,813,153.45
Austri	68,910,726.10	(17,359.70)	68,893,366.40
Irlandë	31,321,507.82	(1,953.59)	31,319,554.23
Amerikë	4,492,907.81	(850.17)	4,492,057.64
Itali	37,836,241.22	(28,009.60)	37,808,231.62
Poloni	15,657,821.12	(27,512.44)	15,630,308.68
Kosovë	180,060,720.33	(130,352.32)	179,930,369.9
<b>Gjithsej</b>	<b>718,180,515.62</b>	<b>(366,493.60)</b>	<b>717,814,023.91</b>

**Letrat me vlerë (sipas llojit):**

	<b>Vlera e bartur 31 Mars 2023</b>	<b>Humbjet e pritura kreditore</b>	<b>Neto vlera 31 Mars 2023</b>
Bono thesari	34,351,835	(10,777)	34,341,060
Obligacione	595,968,913	(360,386)	595,608,526
<b>Gjithsej</b>	<b>630,320,748</b>	<b>(371,163)</b>	<b>629,949,586</b>

	<b>Vlera e bartur 31 Dhjetor 2023</b>	<b>Humbjet e pritura kreditore</b>	<b>Neto vlera 31 Dhjetor 2023</b>
Bono thesari	74,018,087	(19,513)	73,998,576
Obligacione	644,162,429	(346,980)	643,815,448
<b>Gjithsej</b>	<b>718,180,516</b>	<b>(366,494)</b>	<b>717,814,024</b>

## 8. Plasmanët në tregun e parasë

Në kuadër të këtij grupimi bëjnë pjesë plasmanët në tregun e parasë në bankat tona korrespondente dhe huadhëniet e likuiditetit me bankat e nivelit të dytë e mbështetur me kolateral të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës përmes ekzekutimit të marrëveshjes për riblerjeje.

Norma e kamatës për këto plasmane deri në tremujorin e tretë 2023 mesatarisht është rreth 4.75% (minimum: 3.70% dhe maksimum: 5.30%), ndërsa në periudhën e njëjtë në vitin 2023: në mesatare prej 3.58% ( minimum: 0.05% dhe maksimum: 5.30%). Plasmanet me banka korrespondente kryesisht kanë maturitet të kontraktuar deri në një vit, ndërsa huadhëniet e likuiditeti kanë maturitet deri në dhjetë ditë.

Analitika sipas institucioneve/bankave është e shpalosur në tabelën si më poshtë:

<b>Plasmanët në tregun e parasë sipas bankave:</b>	<b>Vlera e bartur 31 Mars 2024</b>	<b>Humbjet e pritura kreditore</b>	<b>Neto vlera 31 Mars 2024</b>
Deutsche Bank	30,000,000.00	(1,421.19)	29,998,578.81
Banque centrale du Luxembourg	150,000,000.00	(9,744.86)	149,990,255.14
Deutsche Bundesbank	70,000,000.00	(23,875.76)	69,976,124.24
Federal Reserve Bank (FED-NY)	5,549,902.88	(916.87)	5,548,986.01
DZ Bank AG	10,000,000.00	(24.79)	9,999,975.21
Banka Kombëtare Tregtare Sh.A.	16,165,000.00	(7,279.96)	16,157,720.04
	<b>281,714,902.88</b>	<b>(43,263.43)</b>	<b>281,671,639.45</b>
<b>Interesi i përlogaritur (akruar) në plasmanët në tregun e parasë</b>			
Deutsche Bank	74,466.67	-	74,466.67
Banque centrale du Luxembourg	362,972.22	-	362,972.19
Deutsche Bundesbank	30,333.33	-	30,333.33
Federal Reserve Bank (FED-NY)	1,634.14	-	1,634.14
DZ Bank Ag	15,166.67	-	15,166.67
Banka Kombëtare Tregtare Sh.A.	8,531.53	-	8,531.53
	<b>493,104.56</b>	<b>-</b>	<b>493,104.53</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>282,208,007.44</b>	<b>(43,263.43)</b>	<b>282,164,743.98</b>

  

<b>Plasmanët në tregun e parasë sipas bankave:</b>	<b>Vlera e bartur 31 Dhjetor 2023</b>	<b>Humbjet e pritura kreditore</b>	<b>Neto vlera 31 Dhjetor 2023</b>
Deutsche Bank	25,000,000.00	(7,066.77)	24,992,933.23
Banque centrale du Luxembourg	150,000,000.00	(12,122.37)	149,987,877.63
Deutsche Bundesbank	25,000,000.00	(8,092.77)	24,991,907.23
Federal Reserve Bank (FED-NY)	5,158,371.04	(976.42)	5,157,394.62
DZ Bank AG	-	-	-
Banka Kombëtare Tregtare Sh.A.	-	-	-
	<b>205,158,371.04</b>	<b>(28,258.33)</b>	<b>205,130,112.71</b>
<b>Interesi i përlogaritur (akruar) në plasmanët në tregun e parasë</b>			
Deutsche Bank	63,000.00	-	63,000.00
Banque centrale du Luxembourg	49,000.00	-	49,000.00
Deutsche Bundesbank	8,062.50	-	8,062.50
Federal Reserve Bank (FED-NY)	2,278.28	-	2,278.26
DZ Bank AG	-	-	-
Banka Kombëtare Tregtare Sh.A.	-	-	-
	<b>122,340.78</b>	<b>-</b>	<b>122,340.76</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>205,280,711.82</b>	<b>(28,258.33)</b>	<b>205,252,453.47</b>

Nëse i krahasojmë periudhën raportuese me periudhën krahasuese ka një rritje të konsiderueshme (relative) në mes të këtyre dy periudhave, që kryesisht është rrjedhë normale e menaxhimit të portfolios si dhe e ndikuar nga mundësia e plasimit pas rritjes së normave në valutën euro.

## 9. Mjetet e ndërlidhura me FMN

	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
Kuota me FMN/Rezerva e paguar	24,562,580.41	24,429,650.16
Depozitat në DST (SDR)	152,683,509.35	152,619,115.39
Kamata akruale	1,178,257.48	1,212,270.71
<b>Gjithsej</b>	<b>178,424,347.24</b>	<b>178,261,036.26</b>

Zërat më lart rrjedhin nga anëtarësimi i Kosovës në FMN. Kuota me FMN/Rezerva e paguar paraqet vlerën paguar të kuotës së obligueshme (82,600,000 SDR nga muaji shkurt 2016; ndërsa fillimisht ka qenë 59,000,000 SDR) që i është përcaktuar Kosovës nga FMN-ja e shprehur në euro.

Depozitat në DST (SDR) paraqet fillimisht vlerën e depozituar në DST në emër të Republikës së Kosovës sipas vendimeve të Bordit të Guvernatorëve të FMN-së më 28 gusht 2009 (43,737,278 SDR) dhe 9 shtator 2009 (11,631,135 SDR) e ndryshuar për transaksionet – të hyrat dhe shpenzimet e interesit dhe pagesat në emër të rritjes së kuotës po ashtu të shprehura në euro në tabelën më lart. Si dhe alokimi/shpërndarje e re 2021 (sipas përkufizime të FMN-së) në vlerë prej 79,168,385 DST (SDR) e miratuar nga Bordi i Guvernatorëve të FMN-së më datë 02 gusht 2021 dhe më datë efektive 23 gusht 2021. Si rrjedhojë zëri i DST-ve në FMN në emër të Republikës së Kosovës është rritur për vlerën në fjalë nga data efektive e transaksionit.

Depozitat në DST – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes (Special Drawing Rights – SDR) janë depozita që sjellin interes mesatarisht prej 4.09% për periudhën raportuese janar - mars 2024 (ndërsa për janar – dhjetor 2023, 3.85%).

Ndërsa, se si zëra jashtë bilancor (zotime ndaj FMN-se) BQK ka kjo shumë e këtyre zotimeve me 31 Mars 2024 është 69.5 milion euro (në periudhën krahasuese kjo vlerë ka qenë 75.4 milion euro). Të rrjedha nga shfrytëzimi i fondeve të qeverisë së Kosovës nga FMN.

## 10, 11 Mjetet e prekshme dhe të paprekshme

<b>Mjetet e prekshme përbëhen si më poshtë:</b>						
<b>Kosto</b>	<b>Investime në objekte</b>	<b>Pajisje</b>	<b>Kompjuter</b>	<b>Automjete</b>	<b>Aktivet në proces</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>Më 01 Janar 2023</b>	<b>6,113,235.74</b>	<b>2,528,258.52</b>	<b>1,910,664.49</b>	<b>389,349.16</b>	-	<b>10,941,507.91</b>
Blerje	10,909.00	243,112.66	377,780.64	-	3,680.00	635,482.30
Transfere (nga)/në (korrigjim)	-	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje)	-	(6,123.00)	(5,797.85)	-	-	(11,920.85)
<b>Më 31 Dhjetor 2023</b>	<b>6,124,144.74</b>	<b>2,765,248.18</b>	<b>2,282,647.28</b>	<b>389,349.16</b>	<b>3,680.00</b>	<b>11,565,069.36</b>
<b>Më 01 Janar 2024</b>	6,124,144.74	2,765,248.18	2,282,647.28	389,349.16	3,680.00	11,565,069.36
Blerje	-	23,609.29	58,194.08	-	-	81,803.37
Transfere (nga)/në (korrigjim)	-	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje)	-	(3,299.01)	(4,669.45)	-	-	(7,968.46)
<b>Më 31 Mars 2024</b>	<b>6,124,144.74</b>	<b>2,785,558.46</b>	<b>2,336,171.91</b>	<b>389,349.16</b>	<b>3,680.00</b>	<b>11,638,904.27</b>
<b>Zhvlerësimi</b>						
<b>Më 01 Janar 2023</b>	2,297,661.00	2,344,203.84	1,738,268.35	366,282.53	-	6,746,415.72
Zhvlerësimi i vitit	310,505.05	103,461.32	126,243.58	13,840.00	-	554,049.95
Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje)	-	(6,123.00)	(5,012.39)	-	-	(11,135.39)
<b>Më 31 Dhjetor 2023</b>	<b>2,608,166.05</b>	<b>2,441,542.16</b>	<b>1,859,499.54</b>	<b>380,122.53</b>	-	<b>7,289,330.28</b>
<b>Më 01 Janar 2024</b>	2,608,166.05	2,441,542.16	1,859,499.54	380,122.53	-	7,289,330.28
Zhvlerësimi i vitit	78,037.37	27,058.76	37,197.53	3,460.00	-	145,753.66
Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje)	-	-	(3,932.22)	-	-	(3,932.22)
<b>Më 30 Mars 2024</b>	<b>2,686,203.42</b>	<b>2,468,600.92</b>	<b>1,892,764.85</b>	<b>383,582.53</b>	-	<b>7,431,151.72</b>
<b>Neto vlera e bartur</b>						
<b>Më 01 Janar 2023</b>	<b>3,815,574.74</b>	<b>184,054.68</b>	<b>172,396.14</b>	<b>23,066.63</b>	-	<b>4,195,092.19</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2023</b>	<b>3,515,978.69</b>	<b>323,706.02</b>	<b>423,147.74</b>	<b>9,226.63</b>	<b>3,680.00</b>	<b>4,275,739.08</b>
<b>Më 31 Mars 2024</b>	<b>3,437,941.32</b>	<b>316,957.54</b>	<b>443,407.06</b>	<b>5,766.63</b>	<b>3,680.00</b>	<b>4,207,752.55</b>

**10, 11 Mjetet e prekshme dhe të paprekshme (vazhdim)****Mjetet e paprekshme përbëhen si më poshtë:**

<b>Kosto</b>	<b>Programe kompjuterike</b>	<b>Programe kompjuterike në proces</b>	<b>Gjithsej</b>
<b>01 Janar 2023</b>	<b>3,186,844.78</b>	-	<b>3,186,844.78</b>
Blerje	139,365.86	-	139,365.86
Transfere (nga)/në (korrigjim)	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
<b>31 Dhjetor 2023</b>	<b>3,326,210.64</b>	-	<b>3,326,210.64</b>
<b>01 Janar 2024</b>	3,326,210.64	-	3,326,210.64
Blerje	15,500.00	-	15,500.00
Transfere (nga)/në (korrigjim)	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
<b>Më 31 Mars 2024</b>	<b>3,341,710.64</b>	-	<b>3,341,710.64</b>
<b>Amortizimi</b>			
<b>01 Janar 2023</b>	2,144,320.68	-	2,144,320.68
Amortizimi për vitin	285,570.68	-	285,570.68
Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje)	-	-	-
<b>Më 31 Dhjetor 2023</b>	<b>2,429,891.36</b>	-	<b>2,429,891.36</b>
<b>Më 01 janar 2023</b>	2,429,891.36	-	2,429,891.36
Amortizimi për vitin	63,859.02	-	63,859.02
Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje)	-	-	-
<b>Më 30 Mars 2024</b>	<b>2,493,750.38</b>	-	<b>2,493,750.38</b>
<b>Neto vlera e bartur</b>			
<b>Më 01 Janar 2023</b>	<b>1,042,524.10</b>	-	<b>1,042,524.10</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2023</b>	<b>896,319.28</b>	-	<b>896,319.28</b>
<b>Më 31 Mars 2024</b>	<b>847,960.26</b>	-	<b>847,960.26</b>



**12. Mjetet tjera**

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
Llogarit e arkëtueshme	2,066,974.50	2,325,158.41
Parapagime	20,972.34	150,423.49
Pagesa/Kërkesa në proces (SNP/DepoX)	75,000.00	-
<b>Gjithsej</b>	<b>2,162,946.84</b>	<b>2,475,581.90</b>

Kërkesat në proces (SNP/DepoX) do të shlyhen pasi sistemi të ekzekuton pagesat në ditën e parë të ardhshme të punës.

**13. Detyrimet ndaj bankave në vend**

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
ProCredit Bank	91,823,946.53	57,933,006.82
Raiffeisen Bank	81,665,432.96	74,171,335.72
NLB Prishtina	91,082,223.30	101,149,058.49
Banka Ekonomike	37,461,159.84	74,377,642.89
Banka për Biznes	38,797,858.41	54,243,862.01
Banka Kombëtare Tregtare	65,064,449.65	107,318,400.93
Turk Ekonomi Bankasi Sh.A.	80,316,696.93	68,284,335.55
Komercijalna Banka/NLB - Dega Mitrovicë	7,446,748.79	7,480,455.46
Turkiye Is Bankasi A.S.	7,877,722.54	8,016,387.33
T.C. Zirat Bankasi A.S.Dega Kosovë	8,982,435.87	21,409,848.44
Banka Kreditore e Prishtinës	195,257.21	43,908.36
Banka Credins Kosovë	3,958,888.60	2,837,812.07
PriBank Sh.A.	13,929,257.79	13,239,325.81
<b>Gjithsej (pa interes akrual)</b>	<b>528,602,078.42</b>	<b>590,505,379.88</b>
Interesi akrual	122,057.91	116,692.73
<b>Gjithsej</b>	<b>528,724,136.33</b>	<b>590,622,072.61</b>

Të shpalosura në këtë grup janë saldot e bankave të nivelit të dytë që operojnë në vend (Kosovë). Dhe të cilat në BQK mbajnë mjetet sipas rregullativës ligjore për rezervën e likuiditetit.

Në total shuma e shpalosur më lart për periudhën raportuese 31 Mars 2024 është rreth 2 herë më e lartë se sa vlera e rezervës së obliguar që kërkohet të mbahet në BQK (ndërsa ky raport më 31 dhjetor 2023 po ashtu 2.35 herë). Nga 1 janari 2023, BQK-ja aplikon normë pozitive 0.15% (vjetore) ndërsa nga 1 gusht 2023 aplikon normë 0.30% për të gjithë depozituesit e BQK-së.

Të njëjtën normë e aplikon në saldot e bankave komerciale në BQK deri në nivelin rezervën minimale të detyrueshme. Për bankat që kanë saldo mbi nivelin e rezervës minimale të

detyrueshme, interesi do të aplikohen deri në vlerën e rezervës minimale të detyrueshme në nivel të bankës.

#### 14. Detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN

	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
Llogaria shpenzimeve FMN Nr. 2	5,596.82	5,566.53
Detyrime ndaj qeverise (pjesa e paguar e Kuotës të FMN-ja)	19,449,624.37	19,117,864.99
Alokime nga FMN-ja në formë të DST	164,693,292.76	163,801,988.95
Kamata akruale	1,259,318.75	1,291,570.59
<b>Gjithsej</b>	<b>185,407,832.70</b>	<b>184,216,991.06</b>

Zërat më lart paraqesin pozicionet e llogarive të ndërlidhura me FMN-në që kanë rrjedhur pas anëtarësimit të Kosovës në FMN.

Të tre zërat e parë (tabela nën shënim 14) paraqesin llogari të hapura sipas rregullativës së FMN-së, dy janë llogari operative dhe një është llogari në përkujdesje për letrat me vlerë (nota premtuese) që Qeveria e Kosovës i ka lëshuar si nota të pagueshme ndaj FMN-së. Llogaria në përkujdesje ka dy përbërës siç janë: pjesa e papaguar e kuotës së anëtarësisë dhe përdorimi i fondeve të FMN-së nga Kosova.

Pjesa e paguar e kuotës (si detyrim afatgjatë), ka të përfshirë edhe interesin e paguar nga IMF për këtë zë, sipas rregullativës së FMN-së, e cila në tabelë nën shënimin 14 është e shprehur në euro.

Alokimet në formë të Drejtave Speciale të Tërheqjes (DST/SDR) në FMN, përbëhen nga alokimet e përmendura në *shënimin 9* më 28 gusht dhe 9 shtator 2009, si dhe shpërndarja (emetimi/alokimi) në vitin 2021.

Norma e interesit për zërin e alokimeve për periudhën raportuese dhe krahasuese është e njëjtë sikurse tek depozitat DST (SDR).

Në muajin maj 2023 FMN ka aprovuar edhe dy lloje të reja të financimit në emër të Kosovës një Linje kreditore dhe Instrumentin për qëndrueshmëri dhe stabilitet (buxhetor). Të dy këta instrument financiarë janë aktivë nga 25 maj 2023. Po ashtu ka një instrument tjetër aktiv nga viti 2020.

Saldo e tërhequr e mjeteve nga këta instrument financiar me 31 mars 2024 është 69.5 milion euro, ndërsa me 31 Dhjetor 2023 ka qenë 75.4 milion euro, ndryshimi rrjedh nga pagesa e kësteve dhe lëvizja/ndryshimet e kursit të këmbimit EUR/SDR).

**15. Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare**

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare kanë këtë përbërje:

<b>Llogarit rrjedhëse</b>	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
Thesari – Ministria e Financave	345,068,485.03	345,232,251.49
Agjencia Kosovare për Privatizim	167,822,621.39	166,373,337.05
Institucionet e Përkohshme Administrative	43,023.21	99,829.15
<b>Gjithsej llogarit rrjedhëse</b>	<b>512,934,129.63</b>	<b>511,705,417.69</b>
<b>Interesi aktual në llogari rrjedhëse</b>		
Thesari – Ministria e Financave	90,607.84	155,221.79
Agjencia Kosovare për Privatizim	43,281.33	42,790.98
Institucionet e Përkohshme Administrative	11.12	25.79
<b>Gjithsej interesi aktual llogari rrjedhëse</b>	<b>133,900.29</b>	<b>198,038.56</b>
<b>Depozitat afatshkurtra</b>		
Thesari – Ministria e Financave	100,175,555.56	-
Agjencia Kosovare për Privatizim	-	-
Institucionet e Përkohshme Administrative	-	-
<b>Gjithsej depozitat afatshkurtra</b>	<b>100,175,555.56</b>	<b>-</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>613,243,585.48</b>	<b>511,903,456.25</b>

Depozitat në llogari rrjedhëse nga 1 janar 2023 përfitojnë interes prej 0.15% ndërsa nga 1 gusht 2023 përfitojnë interes prej 0.30%.

Afatizime aktive në periudhën raportuese ka vetëm nga llogaritë e qeverisë (vlera e shpalosur në tabelë), ndërsa edhe më 31 dhjetor 2023 nuk ka pasur afatizime aktive. Ndryshimi është rrjedhë e aktivitetit operativë të institucioneve që përbëjnë grupin.

**16. Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale**

Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale të paraqitura në vijim:

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
Kompanitë e sigurimeve	4,154,802.61	4,151,783.27
Institucione dhe kompani publike	94,650,688.17	236,009,059.11
Fondet e pensioneve jopublike dhe tjera	1,730.69	1,733.31
<b>Gjithsej llogarit rrjedhëse</b>	<b>98,807,221.47</b>	<b>240,162,575.69</b>
<b>Interesi aktual në llogari rrjedhëse</b>		
Kompanitë e sigurimeve	1,073.36	1,072.61
Institucione dhe kompani publike	26,775.15	38,065.84
Fondet e pensioneve jopublike dhe tjera	0.47	0.47
<b>Gjithsej interesi aktual</b>	<b>27,848.98</b>	<b>39,138.92</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>98,835,070.45</b>	<b>240,201,715.61</b>

*Institucionet dhe kompani publike* përbëhen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, llogaritë nga Fondi i Sigurimeve të Depozitave dhe llogaritë në mirëbesim të KEK (Korporatës Energjetike të Kosovës), si përbërës më me peshë. Depozitat në llogari rrjedhëse nga 1 janar 2023 përfitojnë interes prej 0.15% ndërsa nga 1 gusht 2023 përfitojnë interes prej 0.30%.

**17. Detyrimet nga Huamarrja/et**

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
Huamarrje nga Banka Botërore	1,558,590.95	1,661,655.62
<b>Gjithsej</b>	<b>1,558,590.95</b>	<b>1,661,655.62</b>

Kemi dy projekte që janë financuar nga Banka Botërore përmes kredisë: projekti për *Planin e vazhdimësisë së punës* dhe projekti për *Sistemin e pagesave në kohë reale* (RTGS). Projekte këto të implementuara në vitin 2016. Kthimi i mjeteve është me afat mbi 10 vjet.

Ndryshimi rrjedhë si rezultat i pagesave të kryegjësë dhe konvertimit të vlerës DST (SDR) në EUR në datë e raportimit respektivisht si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit EUR/DST (SDR).

**18. Detyrime tjera**

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
Llogari në përkujdesje	758,244.59	757,669.88
Të hyrat e shtyra	102,609.80	111,453.44
Llogari të pagueshme dhe shpenzime akruale	827,356.64	7,693,795.58
Përfitimet afatgjata për punonjësit	658,644.08	658,644.08
<b>Gjithsej llogarit rrjedhëse</b>	<b>2,346,855.11</b>	<b>9,221,562.98</b>

Në kuadër të grupit vërehet zvogëlim në gjithsej saldon e grupit krahasuar më 31 dhjetor 2023. Kryesisht i ndikuar nga zvogëlimi i saldosh të llogarive të pagueshme krahas asaj më 31 dhjetor 2023.

**19, 20 Kapitali i autorizuar dhe Rezervat****Kapitali dhe Rezervat e Përgjithshme**

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
Kapitali i autorizuar	30,000,000.00	30,000,000.00
Fondet rezervë	41,525,187.85	41,525,187.85
Fitimet e mbajtura/ të ardhurat e ndashme	27,631,114.66	-
Rezultati neto i periudhës	8,450,178.41	27,631,114.66
<b>Gjithsej</b>	<b>107,606,480.92</b>	<b>99,156,302.51</b>

Rezultati financiar i periudhës është pozitiv për rreth 8.4 milionë euro, i ndikuar kryesisht nga realizimi i kënaqshëm i të hyrave dhe mbajtja e shpenzimeve sipas planifikimit buxhetor për periudhën raportuese.

Zëri i rivlerësimit valutor në datën e raportimit është në vlerë prej rreth 182 mijë euro (si fitim i përealizuar), zëri i provizioneve për humbjet e pritura kreditore (neto rritja/(zvogëlimi)) është në vlerë rreth 11 mijë euro (si humbje e përealizuar) dhe nëse i përjashtojmë këta dy zëra rezultati financiar mbetet pozitiv prej rreth 18.7 milionë euro (shiko faqe 4 - *Neto rezultati pa efektin e kursit të këmbimit dhe të provizioneve*).

Sipas nenit 56, paragrafi 1.1. të ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ardhurat neto së pari do të shpërndahen në rezervën të përgjithshme derisa shuma totale e kapitalit fillestar dhe rezervat e përgjithshme barazohen me pesë për qind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore.

Pjesa prej 50% e bilancit neto të të ardhurave të realizuara që mbeten pas përmbushjes së kriterit të 5% të përmendur më lart, duhet t'i transferohet Ministrisë së Financave. Ndërsa 50% që mbetet nga të ardhurat e realizuar duhet t'i alokohet llogarisë së rezervës së përgjithshme të BQK-së.

<b>Të ardhurat e ndashme</b>		
<b>Përshkrimi</b>	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>8,450,178.41</b>	<b>27,631,114.66</b>
Nga të cilat janë fitimet (fitimet) e porealizuara nga rivlerësimi	181,792.43	-
Nga të cilat janë humbjet e porealizuara të rivlerësimit të cilat janë realizuar në vitin aktual	-	-
<b>Të ardhurat e ndashme</b>	<b>8,268,385.98</b>	<b>27,631,114.66</b>
<b>Kapitali, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme</b>		
	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
Kapitali	30,000,000	30,000,000
Rezervat e përgjithshme	56,997,394	39,506,756
Të ardhurat e ndashme	8,268,386	27,631,115
<b>Gjithsej Kapitali, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme</b>	<b>95,265,780</b>	<b>97,137,870</b>
<b>Gjithsej detyrimet monetare</b>		
	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
Ndaj bankave komerciale vendore	528,602,078	590,505,380
Ndaj institucioneve qeveritare	613,109,685	511,705,418
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	184,148,514	182,925,420
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	98,807,221	240,162,576
Nga huamarrja/et	1,558,591	1,661,656
Ndaj detyrimeve tjera monetare	757,852	757,474
<b>Gjithsej detyrimet<sup>2</sup> monetare</b>	<b>1,426,983,942</b>	<b>1,527,717,924</b>
<b>Raporti sipas nenit 56, paragrafi 1.1.</b>	<b>6.68%</b>	<b>6.36%</b>

Duhet theksuar se edhe në këtë tremujor (ashtu si edhe periudha krahasuese) plotësohet kushti prej 5% për gjithsej: Kapital, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme. Dhe potencialisht mund të vlerësojmë se mund të këtë saldo të bartjes se rezultatit financiar edhe në vitin 2024. Por, pasi Ligji këtë e trajton vetëm me pasqyra financiare vjetore nuk po shpalosim vlerësimin vjetor për vlerën e mundshme të bartjes.

<sup>2</sup> Përfshijë akrualet.

**21. Të hyrat neto nga interesi**

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Mars 2023</b>
<b>Të hyrat nga interesi</b>		
Prej depozitave në llogarinë rrjedhëse	3,228,206.91	1,559,605.96
Prej afatizimeve në plasmanë	2,469,553.61	752,554.94
Prej letrave me vlerë	3,047,088.29	1,737,265.23
Prej depozitave me llogaritë me FMN (DST/SDR në posedim)	1,571,020.00	1,281,165.19
	<b>10,315,868.81</b>	<b>5,330,591.32</b>
<b>Shpenzimet e interesit</b>		
Ndaj bankave rezidente në llogarinë rrjedhëse	355,811.60	164,811.29
Ndaj institucioneve qeveritare në llogarinë rrjedhëse	440,986.14	263,682.96
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale në llogarinë rrjedhëse	113,655.80	57,277.91
Tjera në llogarinë rrjedhëse	574.71	-
Ndaj Thesarit -Ministria e Financave në depozita afatshkurtra	327,308.52	-
Ndaj llogarive me FMN (DST/SDR të alokuar)	1,689,414.08	1,359,075.89
Nga huazimi/et	3,705.98	4,375.77
	<b>2,931,456.83</b>	<b>1,849,223.82</b>
<b>Të hyrat neto nga interesi</b>	<b>7,384,411.98</b>	<b>3,481,367.50</b>

Siç mund të vërehet nga tabela nën shënimin 21, të hyrat nga interesi janë më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo ka ndikuar që neto të hyrat nga interesi janë më të larta se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Norma mesatare e interesit për neto të hyrat nga interesi (duke marrë në konsideratë vetëm portfolion e angazhuar) për periudhën raportuese është rreth 1.91% (në periudhën e njëjtë të vitit 2023 ka qenë rreth 1.19%).

**22. Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat në shërbime**

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Mars 2023</b>
<b>Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat</b>		
Nga depozitat/tërheqjet në para të gatshme	376,116.50	315,333.00
Nga transferet hyrëse	18,995.00	17,478.61
Nga transferet dalëse	161,300.00	125,649.74
Nga transferet vendore (sistemi i pagesave vendore)	449,368.41	369,052.29
Nga sistemi i regjistrit të kredive	55,663.22	45,219.80
Të hyra nga tarifa tjera	5,667.00	4,508.00
	<b>1,067,110.13</b>	<b>877,241.44</b>
<b>Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat</b>		
Prej qarkullimit të parasë së gatshme	316,721.20	329,927.20
Nga transaksionet me banka korrespondente	11,789.20	2,105.04
	<b>328,510.40</b>	<b>332,032.24</b>
<b>Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat</b>	<b>738,599.73</b>	<b>545,209.20</b>

Vërehet një rritje e lehtë në neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kjo është nga rrjedha normale e aktivitetit për zërat e shpalosur në kuadër të grupit (ndryshim në volum veçanërisht të *aktiviteti i qarkullimit të parasë së gatshme, transferet dalëse (ndërkombëtare)* si dhe *transferet vendore*).

**23. Të hyrat nga aktiviteti rregullator**

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Mars 2023</b>
Nga mirëmbajtja e licencave të bankave	1,221,000.00	1,076,000.00
Nga licencat prej institucioneve bankare	12,200.00	13,700.00
Nga mirëmbajtja e licencave të kompanive të sigurimeve	516,000.00	430,000.00
Nga licencat prej kompanive të sigurimeve	18,400.00	9,900.00
Të hyrat nga aktiviteti rregullator i fondeve pensionale	6,500.00	6,500.00
Nga aktiviteti rregullator i institucioneve tjera financiare (jo-bankare)	64,400.00	72,853.68
<b>Gjithsej</b>	<b>1,838,500.00</b>	<b>1,608,953.68</b>

Ndryshimi si rritje kryesisht është i mbështetur në rritjen e bazës (bazës përlllogaritëse/volumit të aktivitetit) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

**24. Të hyrat nga grantet**

	31 Mars 2024	31 Mars 2023
<b>Të hyrat nga grantet</b>	<b>8,773.64</b>	<b>9,108.00</b>

Granti për *sistemin e mbikëqyrjes financiare* është granti i vetëm aktive (ne të hyra) për periudhën janar- qershor 2024. Ndërsa, presim rimburesime edhe nga Granti me BQE (ECB) për trajnimet përmes tij.

**25. Të hyrat tjera operative**

	31 Mars 2024	31 Mars 2023
<b>Të hyra tjera</b>	<b>1,798.26</b>	<b>1,783.22</b>

Ky grup përbëhet nga të hyra prej aktiviteteve jo të zakonshme të BQK-së dhe të cilat nuk kanë mundur të klasifikohen në zërat specifike të të hyrave. P.sh. shitja e tokenëve që përmbajnë certifikata për qasje në sistem Depo-x, për klientët shfrytëzues të sistemit në fjalë, kryesisht ndaj bankave komerciale dhe të ngjashme.

**26. Shpenzimet e personelit**

	31 Mars 2024	31 Mars 2023
Shpenzimet e pagave dhe kompensimeve	915,952.54	910,119.99
Shpenzimet e kontributeve dhe sigurimi shëndetësor	230,268.94	229,381.46
Shpenzimet e trajnimeve	13,923.82	27,600.33
Shpenzimet për Bordin e BQK-së	32,766.97	29,129.78
Shujta ditore	57,147.50	58,128.50
Shpenzime tjera	3,607.40	2,777.34
<b>Gjithsej</b>	<b>1,253,667.17</b>	<b>1,257,137.40</b>

Gjithsej numri i të punësuarve që kanë qenë aktivë në listën e pagave gjatë periudhës janar – mars 2024 është: 224 (në periudhën janar – mars 2023, 231).

Në kategorinë *tjera te shpenzimet e personelit* periudha e njëjtë janar – mars: përmbanë *kompensimi shtesë pensional* (2024, 2,264.13 euro; 2022, 2,264.13 euro), *mbështetja financiare për strehim* (2024, 418.47 euro; 2023, 513.21 euro) dhe *programi i praktikës së studentëve* (2024, 924.80 euro, 2023, 0/zero euro).

Kompensimi shtesë pensional është rrjedhojë e vendimeve të mëhershme, nga ku disa ish punëtorë kompensohen drejtpërdrejt nga BQK-ja, në pamundësi për bartjen e këtij detyrimi ndaj tyre te fondet pensionale në momentin kur BQK-ja ka bartur menaxhimin e fondit shtesë pensional.



**27. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative**

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Mars 2023</b>
Shpenzimet e sigurimit	67,609.22	102,499.97
Shpenzimet e operative të parasë se gatshme	7,254.91	9,589.35
Riparime dhe mirëmbajtje	14,431.49	15,461.98
Mirëmbajtje të aplikacioneve	87,948.50	106,449.91
Shpenzime komunikimi (telefoni, fax-i dhe interneti)	1,035.76	1,106.59
Shpenzimet e shërbimeve publike/komunale	21,044.66	19,294.83
Shpenzimet e jashtme (përkthime, konsultimeve dhe të auditimit)	4,042.48	552.48
Udhëtimet zyrtare dhe transporti	11,412.88	13,925.85
Shpenzimet operative të automjeteve	1,776.85	865.03
Material shpenzues administrativ	707.50	55.15
Shpenzimet e byfesë (për kafe ndaj personelit dhe takime të ndryshme)	5,831.33	7,948.88
Shpenzime për furnizime (për pajisje me kosto jo-materiale)	1,233.53	3,822.19
Publikimet dhe literatura	8,318.99	574.00
Tarifa anëtarësimi në institucione profesionale	11,067.48	3,601.38
Shpenzimet e përfaqësimit dhe tjera	4,062.60	3,463.72
<b>Gjithsej</b>	<b>247,778.18</b>	<b>289,211.31</b>

Ndryshimet të shpenzimet e përgjithshme administrative janë rrjedhë e aktiviteteve dhe vendimeve operative, si dhe pjesërisht nga ndonjë aktivitet që nuk ka pasur rrjedhë të njëjtë në periudhat krahasuese. Por, nëse i shikojmë si tërësi dhe në analitik të gjitha janë brenda trendit të tyre të zakonshëm dhe të planifikuar.

**28. Neto rezultati nga ndryshimet e kursit të këmbimit**

	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Mars 2023</b>
<b>Rivlerësimi valutor</b>		
nga zëri/at ne USD	220,197.05	(189,801.87)
nga zërat ne SDR	(38,404.62)	67,027.03
<b>Neto fitimi/(humbja) e porealizuar (nga ndryshimi i kursit të këmbimit)</b>	<b>181,792.43</b>	<b>(122,774.84)</b>

Rezultati i paraqitur më lart është i përkohshëm (specifikishtë vetëm për datën e raportimit) dhe mund të lëvizë varësisht nga lëvizja e kursit të këmbimit EUR/SDR dhe EUR/USD.

**29. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj**

	<b>Shënim</b>	<b>31 Mars 2024</b>	<b>31 Dhjetor 2023</b>
Paraja e gatshme	5	114,278,378.30	101,931,866.18
Llogaritë rrjedhëse me bankat jo rezidente	6	324,765,957.55	424,842,745.30
Plasmanët në tregun e parasë dhe me maturitet deri në tre muaj		282,208,007.44	205,280,711.82
<b>Gjithsej</b>		<b>721,252,343.29</b>	<b>732,055,323.30</b>

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen për qëllim të përmbushjes së detyrimeve të likuiditetit kryesisht afatshkurtër. Një investim kualifikohet si ekuivalent i parasë kur ai ka maturitet afatshkurtër, më pak se tre muaj nga data e blerjes.

**30. Detyrimet e pritura dhe kontingjente****Anëtarësimi në Bankën Botërore**

Pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bankën Botërore dhe nënagjencionet e saj, Qeveria e Kosovës ka lëshuar nota të pagueshme (sipas kërkesës) duke u zotuar se do të paguajë sipas kërkesës së Bankës Botërore (nënagjencioneve të saj) për pjesën e tarifës së anëtarësisë. Vlera e tyre më 31 Mars 2024 është rreth 718,381 euro (më 31 dhjetor 2023 ky detyrim i pritshëm ka qenë 718,218 euro), BQK luan rolin e ndërmjetësit financiar (bankës garantuese) dhe mjetet mbahen në llogari nën përkujdesje (garantuese).